

Çfarë duhet të bëni për të qenë vetëprodhues?



1. Të jeni një klient i energjisë elektrike që ka një kontratë furnizimi me energji elektrike me një furnizues të licencuar.

2. Të instaloni impiantin fotovoltaiik (energji nga dielli) në objektin e banimit në pronësinë/ përdorimin tuaj në përputhje me udhëzimin e MIE Nr. 3 datë. 20/06/2019

3. Të aplikoni pranë Qendrave të Kujdesit të Klientit të OSSH, për të përfituar statusin e vetë prodhuesit të energjisë elektrike.

4. Të kryeni pagesën e tarifave të aplikimit për të marrë statusin e vetë prodhuesit, sipas fuqisë së instaluar të kërkuar, por jo më shumë se 500 kWh. Për më shumë shihni Vendimin Nr. 234, datë 20/12/2019 Ankesi 3.

5. Të plotësoni kërkesat ligjore, teknike për të përfituar statusin e vetë prodhuesit të energjisë elektrike që përfshijnë: plotësimin e formularit të aplikimit, deklaratën e konsumit mesatar të tij përgjatë një viti.

6. Të keni marrë miratimin e kërkesës suaj për të vetë prodhuar energji. **Kujdes!** OSSH miraton apo refuzon kërkesën brenda 30 ditëve nga aplikimi juaj bazuar në Udhëzimin nr.3, datë 26.06.2019 në pikën 13 dhe 14 të tij.

7. Me marrjen e miratimit të OSSH, keni të drejtë të lidheni me rrjetin, e të injektoni në të energjinë e vetëprodhuar.

8. Vlera në lekë e energjisë së prodhuar nga impianti juaj fotovoltaiik, llogaritur mbi cmimin e miratuar, ku teprica e energjisë, më e madhe se konsumi mujor, do t'i shitet Furnizuesit të Shërbimit Universal për vetëkonsum nga kjo kategori konsumatorësh.

Për më shumë gjeni **Udhëzimin nr. 3 datë 26.06.2019.**